



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Zyra e Kryeministrit/Ured Premijera/Office of the Prime Minister
Zyra për Qeverisje të Mirë / Kancelarja za Dobro Upravljanje / Office on Good Governance

Prishtinë 13 dhjetor 2017

**Mbështetje financiare për projektet e OJQ-ve në promovimin e mbrojtjes nga
diskriminimi**

Udhëzimet për Aplikantët

Data e hapjes së thirrjes: 13 dhjetor 2017

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve: 08 Janar 2018 ora 16:00

Permbajtja

1. MBËSHTETJE FINANCIARE PËR PROJEKTET E OJQ-VE NË PROMOVIMIN EMBROJTJES NGA DISKRIMINIMI	3
1.1 PROBLEMET TË CIALAT SYNOHET TË ADRESOHEN PËRMES KËSAJ THIRRJE PUBLIKE.....	3
1.2 OBJEKTIVAT E THIRRJES DHE PRIORITETET PËR NDARJEN E FONDEVE.....	4
1.3 VLERA PLANIFIKUAR E MBËSHTETJES FINANCIARE PËR PROJEKTET DHE TOTAL I THIRRJES	4
2. KUSHTET FORMALE TË THIRRJES	5
2.1. Aplikuesit e pranueshëm: kush mund të aplikoj?	5
2.2 Partnerët e pranueshme në zbatimin e projektit/programit	6
2.3 Aktivitetet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes	6
2.4 Shpenzimet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes.....	7
2.4.1 Shpenzimet e drejtpërdrejta të pranueshme	7
2.4.2 Shpenzimet e tërthorta të pranueshme	8
2.4.3 Shpenzimet e papranueshme	8
3. SI TË APLIKONI?	8
3.1 Formulari i aplikacionit të projektpropozimit	9
3.2 Përmbajtja e formës Buxhetit.....	9
3.3 Ku ta dorëzoni aplikimin?.....	9
3.4 Afati i fundit për dërgimin e aplikacioneve	10
3.5 Si të kontaktoni nëse keni ndonjë pyetje?.....	10
4.VLERËSIMI DHE NDARJA E FONDEVE	11
4.1 Aplikacionet e pranuar do të kalojnë nëpër procedurën e mëposhtme:.....	11
4.2 Dokumentacion shtesë dhe Kontraktimi	11
5.KALENDARI INDIKATIV I REALIZIMIT TË THIRRJES	12
6.LISTA E DOKUMENTEVE TË THIRRJES PUBLIKE	12

1. MBËSHËTETJE FINANCIARE PËR PROJEKTET E OJQ-VE NË PROMOVIMIN EMBROJTJES NGA DISKRIMINIMI

1.1 PROBLEMET TË CIALAT SYNOHET TË ADRESOHEN PËRMES KËSAJ THIRRJE PUBLIKE

Republika e Kosovës e ka shënuar progres gjatë viteve të fundit në krijimin e Kornizës ligjore për mbrojtjen nga diskriminimi. Përveç kësaj, disa nga dokumentet kryesore ndërkombëtare nga fusha e të drejtave të njeriut janë pjesë përbërëse e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke i bërë normat e tyre drejtpërdrejtë të zbatueshme në Kosovë. Prandaj, Republika e Kosovës është e përkushtuar dhe i trajton me prioritet përmeshjen e obligimeve që dalin nga normat e këtyre dokumenteve duke punuar në vazhdimësi për të siguruar realizimin e të gjitha të drejtave themelore të njeriut për të gjithë qytetarët e republikës së Kosovës pa asnjë lloj diskriminimi. Një punë e madhe është bërë edhe në drejtim të themelimit dhe funksionalizimit të mekanizmave institucional që merren me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, dhe në veçanti ato që merren me mbrojtjen nga diskriminimi.

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi i miratuar në vitin 2015 garanton një kornizë të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit mbi çfarëdo baze dhe i njëjti është në përputhje me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, duke përfshirë ato të Bashkimit Evropian. I njëjti ligj duhet të zbatohet si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat dhe ka avancuar kornizën ligjore të Republikës së Kosovës për mbrojtje nga diskriminimi. Aty janë paraparë edhe institucionet përgjegjëse për trajtimin e rasteve të diskriminimit. Edhe Zyra e Kryeministrit ka një rol dhe mandat të qartë në veçanti në fushën e promovimit dhe bashkëpunimit në avancimin e të drejtave të njeriut. Në nenin 10 të ligjit, përkatësisht paragrafin 2 të nenit 10, është paraparë edhe bashkëpunimi me shoqërinë civile, respektivisht me Organizatat Jo Qeveritare të cilat kanë interes për të kontribuar në mbrojtjen nga diskriminimi e në veçanti në promovimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Edhe pse korniza ligjore në fuqi në republikën e Kosovës garanton trajtim të barabartë, dhe po ashtu është në linjë me standardet ndërkombëtare, ekziston një hapësirë e madhe për të avancuar më tej të drejtat e njeriut dhe të grupeve të veçanta, në veçanti me fokus në mbrojtjen nga diskriminimi. Ndonëse progresi është evident, Raporti i Progresit i Komisionit Evropian në vazhdimësi evidenton në gjetjet e tij mangësi sa i përket trajtimit të barabartë dhe mbrojtjes nga diskriminimi. Prandaj, Zyra e Kryeministrit sikur në të kaluarën synon që në bashkëpunim me Organizatat Jo Qeveritare të punoj në promovimin e trajtimit të barabartë përmes projekteve të cilat do të realizohen me OJQ-të.

Në Kosovë ekzistojnë një numër i madh i organizatave Jo Qeveritare të cilat merren me promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të drejtat e fëmijës dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Disa prej OJQ-ve kanë një përvojë të konsiderueshme dhe shumë të nevojshme për promovimin e të drejtave të njeriut dhe trajtimit të barabartë. Prandaj, duke pas parasysh rolin dhe përvojën që kanë Organizatat Jo-qeveritare në promovimin e mbrojtjes nga

diskriminimi, bashkëpunimi me OJQ-të në arritjen e prioriteteve në këtë fushë është tejet i rëndësishëm për Qeverinë e Republikës së Kosovës. Përveç kësaj, Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar Strategjinë për Bashkëpunim me shoqërinë civile, e cila objektivat e saja kryesore i ka të orientuara në rritjen dhe avancimin e bashkëpunimit me shoqërinë civile, respektivisht me Organizatat Jo-Qeveritare.

Prandaj, edhe kjo thirrje publike për përkrahje të projekteve të Organizatave Jo Qeveritare të cilat në programin e tyre janë të fokusuar në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut me fokus në mbrojtjen nga diskriminimi në ndonjërin nga fushat prioritare të thirrjes publike është në funksion të realizimit të prioriteteve qeveritare në këtë fushë si dhe të rritjes së bashkëpunimit me shoqërinë civile për të promovuar, avancuar dhe mbrojtur të drejtat e njeriut dhe mbrojtjen nga diskriminimi.

1.2 OBJEKTIVAT E THIRRJES DHE PRIORITETET PËR NDARJEN E FONDEVE

Objektivi i përgjithshëm i kësaj Thirrje për Propozime është promovimi i trajtimit të barabartë dhe mbrojtjes nga diskriminimi

Objektivi specifik i kësaj Thirrje për Propozime është:

- Ngritja e vetëdijes së opinionit publik për të drejtat ligjore për mbrojtje nga diskriminimi
- Promovimi i mbrojtjes nga diskriminimi për grupet e ndieshme (fëmijët, minoritetet, LGBTI).
- Promovimi i mundësive të barabarta për personat me aftësi të kufizuara

Promovimi i trajtimit të barabartë dhe mbrojtjes nga diskriminimi si dhe forcimi i partneritetit dhe bashkëpunimit me Organizatat Jo-Qeveritare që veprojnë në fushën e promovimit dhe mbrojtjes nga diskriminimi.

Prioritetet për alokimin e fondeve:

- projektet të cilat synojnë ngritjen e vetëdijes së opinionit publik për të drejtat ligjore për mbrojtje nga diskriminimi;
- projektet të cilat fokusohen në promovimin dhe mbrojtjen nga për grupet e ndieshme (fëmijët, minoritetet, LGBTI).
- projektet të cilat synojnë promovimin e mundësive të barabarta për personat me aftësi të kufizuara

1.3 VLERA PLANIFIKUAR E MBËSHTETJES FINANCIARE PËR PROJEKTET DHE TOTAL I THIRRJES

1. Për financimin e projekteve sipas kësaj Thirrje publike është paraparë shuma në dispozicion prej 10,000 euro.
2. Shuma minimale e financimit që mund të alokohet për çdo projekt individual është 1,500 euro, ndërsa shuma maksimale për një projekt është 2,000 euro.

3. Projektet mund të financohen në shumën e 100% të totalit të kostove të pranueshme të projektit. Aplikantët dhe partnerët potencialë nuk është nevojshme të sigurojnë bashkëfinancim nga burimet tjera (publike ose private) të financimit.

2. KUSHTET FORMALE TË THIRRJES

2.1. Aplikuesit e pranueshëm: kush mund të aplikoj?

Aplikanti duhet të jetë:

1. Organizatë jo Qeveritare e regjistruar në pajtim me Ligjin për Lirinë e Asociimit në Organizata Jo-Qeveritare;
2. Të ketë zotësi juridike, financiare dhe operationale për zbatimin e projektit;
3. të kenë përvojë në implementimin e projekteve nga fushat prioritare të thirrjes publike;
4. Të ketë kryer të gjitha detyrimet tatimore dhe kontributet tjera të detyrueshme në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës
5. të mos jetë në proces falimentimi, në proces të shuarjes, në procedura të mbledhjes së detyrueshme apo likuidimit;
6. të mos ketë shkelur kushtet e parashikuar të përdorimit të fondeve publike;

Nuk kanë të drejtë për të konkurruar sipas kësaj thirrje:

1. OJQ-të të cilat nuk i kanë shpenzuar mjetet nga mbështetja e mëparshme financiare publike për qëllimin për të cilin janë dhënë nuk kanë të drejtë konkurrimi
2. OJQ-të e falimentuara;
3. OJQ-të të cilat kanë dështuar të kryejnë detyrimet tatimore dhe kontributet tjera sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës;
4. OJQ-të të cilat mund të kenë konflikt interesi;

Numri i projekteve me të cilat mund të aplikoj një OJQ:

1. Një aplikant mund të paraqesë një projekt propozim.
2. Një aplikant mund të në të njëjtën kohë të jetë partner në një tjetër aplikim.

2.2 Partnerët e pranueshme në zbatimin e projektit/programit

1. Për zbatimin e projektit nuk është e detyrueshme ekzistenca e partneritetit me organizata të tjera por e njëjta është e dëshirueshme.

1. Në rast të ekzistencës së partneritetit, partnerët mund të marrin pjesë në më shumti një aplikim si partner dhe një projekt si bartës.

2. kushtet që duhet ti plotësojnë partnerët në projekt.

Partnerët duhet të përmbushin të gjitha kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për aplikuesit, siç është paraparë në pikën e specifikuar në pikën 2.1 të këtyre udhëzimeve.

3. Raporti në mes të Aplikantit dhe partnerëve

Me rastin e aplikimit, aplikuesi duhet të ketë arritur marrëveshje të partneritetit me OJQ-të partnere. Për këtë qëllim duhet nënshkruar një deklaratë e partneritetit, e cila duhet të dorëzohet në kopje origjinale të nënshkruar nga secili partner në projekt.

2.3 Aktivitetet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes

- Kohëzgjatja e planifikuar e projekteve është 6 muaj.
- Aktivitetet e projektit duhet të kryhen në territorin e Republikës së Kosovës
- Aktivitetet e pranueshme të projektit mund të përfshijnë:
 - ✓ Aktivitete që synojnë ngritjen e vetëdijes së publikut për mbrojtje nga diskriminimi në ndonjërin nga fushat prioritare të thirrjes publike;
 - ✓ Aktivitetet që kanë për qëllim nxitjen e institucionet publike dhe akterëve tjerë për bashkëpunim me shoqërinë civile në promovimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi në ndonjërin nga fushat prioritare të thirrjes publike;
 - ✓ Aktivitete që synojnë avancimin e politikave qeveritare në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi në fushat prioritare të thirrjes publike;
 - ✓ Aktivitete mentorimi dhe trajnimi i stafit të OJQ-ve që operojnë në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të mbrojtjes nga diskriminimi;
 - ✓ aktivitetet që synojnë nxitjen e komunikimit të OJQ-ve me publikun, me fokus në informimin e publikut për mbrojtjen nga diskriminimi;

Lista e aktiviteteve të projektit nuk është e mbyllur, por vetëm ilustruese dhe do të merren

parasysh për financim edhe aktivitete tjera të përshtatshme që kontribuojnë në arritjen e objektivave të përgjithshme dhe specifike të thirrjes, të cilat nuk janë të përmendura në listën më lart.

Gjatë zbatimit të aktiviteteve të projektit, aplikuesi duhet të sigurojë që bazohet në parimin e ofrimit të mundësive të barabarta, barazisë gjinore dhe jo-diskriminimit, si dhe të zhvillojë veprimtari në përputhje me nevojat e komunitetit dhe qytetarëve.

4. Llojet e mëposhtme të aktiviteteve nuk janë të pranueshme për financim:

- ✓ Aktivitete të cilat nuk kanë të bëjnë me promovimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi
- ✓ Aktivitetet në të cilat përfitues të vetëm janë anëtarët e OJQ-së aplikuese;

2.4 Shpenzimet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes

Përmes fondeve publike të kësaj thirrje publike mund të financohen vetëm kostot reale dhe të pranueshme për realizimin e aktiviteteve të projektit, në periudhën kohore të specifikuar me këto udhëzime. Në vlerësimin e projektit do të vlerësohen vetëm kostot e nevojave në lidhje me aktivitetet e planifikuara, si dhe në lartësinë reale të këtyre shpenzimeve.

2.4.1 Shpenzimet direkte të pranueshme

Shpenzimet sipas kostove të pranueshme direkte përfshijnë shpenzimet që janë direkt të lidhura me zbatimin e disa aktiviteteve projektit ose të programit të propozuar, të tilla si:

- ✓ organizimi i aktiviteteve edukuese, tryeza të rrumbullakëta (në mënyrë të veçantë duhet të identifikohet lloji dhe çmimi i secilit shërbim);
- ✓ material shpenzues;
- ✓ shërbime grafike (shërbimet për shtypjen e fletushkave, broshurave, revistave, etj, duke specifikuar llojin dhe qëllimin e shërbimit, sasinë, çmimin e njësisë, etj.);
- ✓ Shërbimet e reklamimit (televizionit dhe radio prezantime, mirëmbajtjes web faqeve, njoftimet në gazeta, materiale reklamuese, etj, duke përcaktuar llojin e promovimit, kohëzgjatjen dhe koston e shërbimeve);
- ✓ Shpenzimet e përfaqësimit që kanë të bëjnë me organizimin e aktiviteteve të projektit duke treguar qëllimin dhe numrin e pritshëm të pjesëmarrësve, etj);
- ✓ Shpenzimet e pagave dhe pagesave për menaxherët e projektit të kontraktorëve të projektit nga organizatat dhe/ose partnerët e jashtëm të përfshirë në projekt (kontratat e të drejtave të autorit dhe të drejtave pronësore, kontratat tjera, kontratat e punësimit), duke specifikuar emrin e personave të angazhuar, kompetencat e tyre profesionale, numrin e muajve të angazhimit dhe shumën mujore bruto të kompensimit;
- ✓ Shpenzimet e komunikimit (shpenzimet e telefonit, internetit, etj) këto shpenzime duhet të jenë të përcaktuara (caktuara);

- ✓ kostoja për prokurimin e pajisjeve të nevojshme për zbatimin e projektit, i cili duhet të jetë i përcaktuar nga lloji dhe shuma;
- ✓ shpenzimet e udhëtimit (aty ku është e nevojshme duke e specifikuar numrin e njerëzve, destinacionit, shpeshësinë dhe qëllimin e udhëtimit dhe llojin e transportit publik, llojin e akomodimit dhe numrin e netëve);
- ✓ kosto të tjera që lidhen drejtpërdrejt me zbatimin e aktiviteteve të projektit apo programit;

2.4.2 Shpenzimet e tërthorta të pranueshme

Përveç shpenzime të pranueshme direkte, në kuadër të kësaj thirrje do të pranohen edhe kostot indirekte (përqindje e vlerës totale të projektit/programit. Në kuadër të këtyre shpenzimeve përfshihen kostot që nuk janë të lidhura direkt me zbatimin e projektit ose programit, por janë kosto që në mënyrë të tërthortë kontribuojë në arritjen e objektivave të projektit. Edhe këto kosto duhet të specifikohen dhe të shpjegohen.

2.4.3 Shpenzimet e papranueshme

Shpenzimet e papranueshme përfshijnë p.sh:

- ✓ investimet në kapital apo kredi për investime, fonde të garancisë;
- ✓ Kostot e blerjes së pajisjeve, mobiljeve, dhe punëve të vogla ndërtimore në qoftë se kalojnë vlerën prej 10% të totalit të kostove të pranueshme të projektit;
- ✓ Shpenzimet e interesit për borxhin;
- ✓ gjobat, ndëshkimet financiare dhe shpenzimet e procedurave gjyqësore;
- ✓ pagesa e bonuse për punonjësit;
- ✓ detyrimet bankare për hapjen dhe administrimin e llogarive, tarifat për transfertat financiare dhe tarifat e tjera krejtësisht të një natyre financiare;
- ✓ Kostot që tashmë janë të financuara nga burime publike apo shpenzime në periudhën e projektit të financuar nga burime të tjera;
- ✓ blerja e pajisjeve të përdorura, makineri dhe mobilje etj;
- ✓ kostot që nuk mbulohen nga marrëveshja (kontrata me ofruesin e mbështetjes financiare);
- ✓ donacionet bamirëse;
- ✓ kredi për organizata të tjera apo individ;
- ✓ kostot e tjera që nuk janë të lidhura direkt me përmbajtjen dhe objektivat e projektit;

3. SI TË APLIKONI?

Aplikimi i OJQ-ve do të konsiderohet i plotë nëse përmban të gjitha format e aplikimit dhe anekset e detyrueshme siç kërkohet në thirrjen publike dhe dokumentacionin e thirrjes si në vijim:

1. Formulari i projekt-propozimit;
2. Formulari i propozim buxhetit;
3. Formulari i deklaratës së partneritetit (nëse aplikohet në partneritet);

4. Kopja e Certifikatës së regjistrimit të OJQ-së;
5. Kopja e Certifikatës së Numrit Fiskal;
6. Forma e deklaratës të mungesës së financimit të dyfishtë;
7. Forma e deklaramit të projekteve apo programeve të OJQ-ve të financuara nga burimet publike të financimit;
8. Deklaratë e dorëzimit të pasqyrave financiare vjetore;
9. Certifikatë nga Administrata Tatimore e Kosovës në lidhje me gjendjen e borxhit publik të aplikuesit dhe partnerëve që vërteton se organizata nuk ka borxh, dhe në rast se ka borxh publik, duhet të paguhen para nënshkrimit të kontratës. Certifikata duhet të jetë lëshuar brenda periudhës që nga data e hapjes së thirrjes publike (ky dokument do të kërkohet para publikimit të rezultateve përfundimtare, dhe pas publikimit të rezultateve preliminare).

3.1 Formulari i aplikacionit të projekt-propozimit

Plotësimi i formës së projekt propozimit është pjesë e dokumentacionit të detyrueshëm. Ajo përmban të dhëna në lidhje me aplikuesin dhe partnerët si dhe të dhëna mbi përmbajtjen e projektit/programit për të cilin kërkohet financim nga burimet publike.

Në rast se në formën e dorëzuar mungojnë të dhënat në lidhje me përmbajtjen e projektit, aplikimi nuk do të merret në konsideratë.

Forma është e nevojshme të plotësohet me kompjuter. Nëse forma është plotësuar me dorë nuk do të merren në konsideratë.

Nëse forma përshkuese përmban të meta si më sipër, aplikimi do të konsiderohet i pavlefshëm.

3.2 Përmbajtja e formës Buxhetit

Forma e plotësuar e propozim Buxhetit është pjesë e dokumentacionit të detyrueshëm. Buxheti i dorëzuar duhet të përmbaj informacion për të gjitha shpenzimet direkte dhe indirekte të projektit/programit të propozuar për financim.

Nëse forma e buxhetit nuk është e plotësuar në tërësi, apo nuk është dorëzuar në formën përkatëse aplikimi nuk do të merret në konsideratë.

Forma është e nevojshme të plotësohet me kompjuter. Nëse forma është plotësuar me dorë nuk do të merret në konsideratë.

3.3 Ku t'a dorëzoni aplikacionin?

Format e detyrueshme dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të dërgohen në formë fizike, të shtypur (një origjinal) dhe në formë elektronike (në CD). Format e detyrueshme duhet të jenë të nënshkruara nga përfaqësuesi i autorizuar dhe të vulosura me vulën zyrtare të organizatës.

Dokumentacioni në formë elektronike (në CD) duhet të ketë të njëjtën përmbajtje, pra të jetë identik me versionin e shtypur. Dokumentacioni i shtypur dhe ai elektronik në CD duhet të vendosen në një zarf të mbyllur.

Aplikimi origjinal duhet të dërgohet me postë ose në person (dhe të dorëzohet në Zyrën përkatëse). Në pjesën e jashtme të zarfit duhet të shënohet emri i thirrjes publike, së bashku me emrin e plotë dhe adresën e aplikuesit dhe shënimin "*Të mos të hapet para takimit të Komisionit Vlerësues*"

Aplikacionet duhet të dërgohen në adresën e mëposhtme:

Zyra e Kryeministrit

Sheshi Nëna Terezë, Prishtinë, kati.6, Zyra nr. 607

"Të mos hapet para mbledhjes së Komisionit Vlerësues"

3.4 Afati i fundit për dërgimin e aplikacioneve

Afati i thirrjes është 15 ditë pune nga data e hapjes së thirrjes dhe zgjatë deri më 05 Janar 2018. Aplikacioni i dorëzuar brenda periudhës së thirrjes gjithashtu pranohet nëse vula pranuese tregon se është dorëzuar në postë deri në fund të datës së thirrjes, si afati i fundit për dorëzimin. Në rast se aplikacioni është paraqitur personalisht në Zyrë, aplikuesit do t'i lëshohet një vërtetim se aplikacioni është pranuar brenda periudhës së konkursit.

Të gjitha aplikacionet e dërguara pas afatit nuk do të merren parasysh.

3.5 Si të kontaktoni nëse keni ndonjë pyetje?

Të gjitha pyetjet në lidhje me thirrjen mund të bëhen vetëm në mënyrë elektronike, duke i dërguar një kërkesë në adresën e mëposhtme: trendeline.dreshaj@rks-gov.net, jo më vonë se 10 ditë para skadimit të thirrjes.

Përgjigjet ndaj kërkesave të veçanta do të dërgohet direkt në adresën e pyetjeve të shtruara, dhe përgjigjet më të shpeshta do të publikohen në faqen e mëposhtme të internetit: www.kryeministri-ks.net dhe jo më vonë se 5 ditë para skadimit të thirrjes

4.VLERËSIMI DHE NDARJA E FONDEVE

4.1 Aplikacionet e pranuar do të kalojnë nëpër procedurën e mëposhtme:

4.1.1 Zyra e Kryeministrit (ZKM) do të themeloj një komision vlerësues të përbërë nga 5 anëtarë nga zyrtar të institucionit dhe ekspert tjerë të jashtëm, i cili ka për detyrë të vlerësoj aplikacionet nëse i plotësojnë kushtet formale të thirrjes publike.

Pas kontrollimit të gjitha aplikacioneve të pranuar, komisioni do të përgatis një listë e të gjithë aplikantëve që i plotësojnë kushtet për tu vlerësuar përmbajtja e projekteve të tyre, dhe një listë të aplikantëve të cilët nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara të konkurrencës.

Ofruesi i mbështetjes financiare (ZKM) do të njoftojë me shkrim të gjithë aplikantët të cilët nuk i plotësojnë kërkesat dhe arsyet e refuzimit të aplikimit të tyre.

4.1.2 Në fazën e dytë do të bëhet vlerësimi i përmbajtjes së aplikimeve nga ana e Komisionit vlerësues i përbërë nga 5 anëtarë. Çdo aplikacion i pranuar do të vlerësohet në bazë të formularit të vlerësimit.

Lista e përkohshme e projekteve/programeve përfituese të përzgjedhura për financim - Në bazë të vlerësimit të aplikacioneve të cilat i kanë plotësuar kushtet e parashikuara të thirrjes, Komisioni do të hartojë një listë të përkohshme të projekteve/programeve të përzgjedhura, sipas pikëve që ata kanë marrë në procesin e vlerësimit. Shuma totale e kostos së projekteve të radhitura në listën e përkohshme nuk do të kaloj shumën totale të ofruar për financim përmes thirrjes publike.

Krahas listës së përkohshme, bazuar në pikat që janë bërë gjatë vlerësimit, Komisioni do të hartojë edhe listën rezervë të projekteve/programeve.

4.2 Dokumentacion shtesë dhe Kontraktimi

Për të shmangur shpenzimet e panevojshme shtesë kur të aplikoni për konkurrencën, Zyra e Kryeministrit do të kërkojë dokumentacion shtesë vetëm nga ata aplikues të cilët, në bazë të procesit të vlerësimit të aplikacioneve, kanë hyrë në listën e përkohshme të projekteve/programeve të përzgjedhura për financim.

Para nënshkrimit përfundimtar të kontratës, dhe në bazë të vlerësimit të Komisionit, Zyra e Kryeministrit mund të kërkojë shqyrtimin e formës së buxhetit për kostot e vlerësuara që korrespondojnë me shpenzimet aktuale në lidhje me aktivitetet e propozuara.

Dokumentacionin shtesë që do të kërkohet: Vërtetimi nga administrata tatimore se janë kryer të gjitha detyrimet tatimore.

Komisioni vlerësues do të bëjë kontrollimin e dokumentacionit shtesë.

Nëse aplikuesi nuk paraqet dokumentacionin e kërkuar shtesë brenda kohës së caktuar prej 10 ditësh, aplikimi do të refuzohet.

Nëse pas kontrollimit të dokumenteve mbështetëse vendoset se disa nga aplikuesit nuk i plotësojnë kushtet e kërkuara të thirrjes publike, nuk do të merret në konsideratë për nënshkrim të kontratës.

Në raste të tilla, projektet nga lista rezervë do të aktivizohen nëse, pas kontrollimit të dokumenteve mbështetëse dhe pasi të konstatohet nga institucioni se ka mjete të mjaftueshme për të kontraktuar projekte të tjera.

Pas kontrollit të dokumentacionit të paraqitur, Komisioni do të propozojë listën përfundimtare të projekteve/programeve të përzgjedhura për financim.

Njoftimi i aplikuesve - Të gjithë aplikuesit të cilët hyjnë në procesin e vlerësimit do të informohen në lidhje me vendimin për ndarjen e projekteve/programeve në kuadër të kësaj thirrje.

5.KALENDARI INDIKATIV I REALIZIMIT TË THIRRJES

Fazat e procedurës së thirrjes:

1. Afati i fundit për aplikimet 08 Janar 2018
2. Afati i fundit për dërgimin e pyetjeve në lidhje me thirrjen është 29 dhjetor 2017
3. Afati i fundit për dërgimin e përgjigjeve për pyetjet që lidhen me thirrjen është 3 Janar 2018
4. Afati për kontraktim është 90 ditë nga data e mbylljes së thirrjes.

Financuesi ka të drejtë të përditësoj kalendarin indikativ. Duhet të dini se çdo ndryshim në kalendarin indikativ do të publikohet në faqen e internetit e mëposhtme: www.kryeministri-ks.net

6.LISTA E DOKUMENTEVE TË THIRRJES PUBLIKE

FORMULARËT

1. *Formulari i Aplikacionit për projekt/programit (word)*
2. *Formulari i Propozim buxhetit (format excel)*
3. *Formulari i deklaratës për mungesë të financimit të dyfishtë (format Word)*
4. *Formular i deklaratës se partneritetit (format word)*
5. *Formulari i Raportit Financiar (formatin excel)*